VENDIM
Nr. 166, datë 28.6.2022

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË BLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE TË PRODHUAR NGA BURIMET E VOGLA TË RINOVUESHME NGA DIELLI, ME FUQI TË INSTALUAR DERI 2 mw, PËR VITIN 2022

Në mbështetje të nenit 10, pika 2, 16 dhe 19, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; nenit 10, pika 3, të ligjit nr. 7/2017, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme"; vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 369, datë 26.4.2017, "Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era"; VKM-së nr. 580, datë 28.8.2019, "Për miratimin e planit të konsoliduar kombëtar të veprimit për burimet e rinovueshme të energjisë, 2019–2020", të ndryshuar dhe nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s; në mbledhjen e tij të datës 28.6.2022, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 935/8 prot., datë 24.6.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve, "Mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli me fuqi të instaluar deri 2 mw për vitin 2022",

konstatoi se:

- ERE ka detyrimin e përcaktimit të çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era, në bazë të nenit 10, pika 3, të ligjit nr. 7/2017, "Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme" dhe VKM-së nr. 369, datë 26.4.2017, "Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era".

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 27, datë 14.2.2022, vendosi fillimin e procedurës, "Mbi përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli, era dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale për vitin 2022".

- ERE, me shkresën nr. 342 prot., datë 2.3.2022, ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Autoritetin e Konkurrencës (AK), ministrin e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes (MSHMS), Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (ASHZHI), si dhe Furnizuesin e Tregut të Lirë (FTL), lidhur me fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli, era dhe nga pjesa e biodegradueshme e mbetjeve të ngurta, që shfrytëzojnë mbeturinat industriale, urbane dhe rurale për vitin 2022.

- MIE, me anë të shkresës nr. 2842 prot., datë 1.4.2022, është shprehur, se, bazuar në VKM-në nr. 822, datë 7.10.2015, "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni", të ndryshuar, për vitin 2022, ka miratuar ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet 2 mw për 5 subjekte.

- Gjithashtu, me anë të shkresë së sipërcituar, MIE ka përcjellë për referencë planet e biznesit të paraqitura nga subjektet mbajtëse të miratimit përfundimtar.

- VKM-ja nr. 369, datë 26.4.2017, "Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era", ka përcaktuar kriteret e llogaritjes së çmimit, duke u bazuar në kthimin e arsyeshëm të vlerës së investimeve, sipas llojit të teknologjisë së përdorur. Në themel të metodologjisë së miratuar me

VKM-në e lartpërmendur është llogaritja e kostos së prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme nëpërmjet formulës llogaritëse të LCOE-së (kosto e niveluar e energjisë elektrike).

- Çmimi i blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli, me fuqi të instaluar deri 2 mw, është një çmim mesatar dhe si i tillë, në vijim dhe të praktikave të viteve të mëparshme, të gjithë komponentët përllogaritës të këtij çmimi janë të mesatarizuar.

- Për llogaritjen e LCOE-së janë marrë në konsideratë të dhëna mbi komponentët përbërës të nevojshëm, nga burimet, si më poshtë vijon:

- Planet e biznesit të shoqërive mbajtëse të miratimit përfundimtar, siç përcillet nga MIE (kostoja e investimit, shpenzimet operative, degradimi vjetor i prodhimit, jetëgjatësia e inverterit);

- VKM-ja nr. 580, datë 28.8.2019, "Për miratimin e planit të konsoliduar kombëtar të veprimit për burimet e rinovueshme të energjisë, 2019–2020", i ndryshuar (kostoja mesatare e ponderuar e kapitalit, periudha e mbështetjes dhe orët mesatare të punës);

- Studimi i IEA-s *(International Energy Agency- Renewables 2021 Analysis and forecast to 2026);*

- Studimi i MDPI-së – Një rishikim i degradimit të moduleve fotovoltaike për jetëgjatësinë *(A Review of the Degradation of Photovoltaic Modules for Life Expectancy).*

- Në zbatim të sa më sipër dhe nisur nga eksperienca e krijuar për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga impiantet prodhuese fotovoltaike deri në 2 mw dhe eolike deri në 3 mw, në periudhat e mëparshme, është llogaritur çmimi i blerjes së energjisë të prodhuar nga impiantet fotovoltaike për vitin 2022, duke përdorur modelin e *Excel*-it të hartuar nga AGORA në studimin e saj për Shqipërinë.

- Në kontratat respektive midis subjekteve mbajtëse të miratimit përfundimtar dhe MIE-s përcaktohet se vlerësimi i investimeve mund të pësojë ndryshime të mundshme, me marrëveshje ndërmjet palëve, në çdo kohë gjatë zbatimit të projektit për ndërtimin e parkut eolik, si dhe MIE, bazuar në raportin përfundimtar të testimit dhe pas paraqitjes nga mbajtësit e miratimit përfundimtar të raportit të plotë të shpenzimeve për ndërtimit e veprës, lëshon certifikatën e pranimit të veprës, sipas legjislacionit në fuqi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga impiantet fotovoltaike me kapacitet të instaluar deri në 2 mw prej 97.21 eurosh/mwh, për vitin 2022.

2. Çdo ndryshim në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi do të përbëjë shkak për rishikimin e këtij vendimi nga ERE.

3. Drejtoria e Tarifave dhe e Çmimeve të njoftojë palët e interesuara për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti